

Pjesa 3

Pjesëmarrja

Njësia 7


Gazeta e klasës

Të kuptuarit e mediave përmes përgatitjes së tyre

NJËSIA 7

Gazeta e klasës

Të kuptuarit e mediave përmes përgatitjes së tyre



7.1. Gazetat përreth nesh

Kë e informojnë. Si na informojnë. Çka na kumtojnë ata.

7.2. Gazeta jonë është më e mira ... a nuk po pajtohesh?

Çka e bën një gazetë të jetë gazetë e mirë?

7.3. Ne përgatisim gazetën tonë të murit

Të gjitha gjërat që “duhet bërë” dhe pak gjëra që “s’duhet bërë”

7.4. Çështja jonë e parë!

Cilët janë hapat e ardhshëm?

NJËSIA 7: Gazeta e klasës

Të kuptuarit e mediave përmes përgatitjes së tyre

Në tërë botën, prania dhe ndikimi i mediave është rritur gjatë viteve të fundit. Sa më komplekse dhe të ndërvarura që bëhen jetët tona, aq më shumë mbështetemi në informacione, për të kuptuar ndikimet dhe zhvillimet nga të cilat ne ndikohemi. Për çdo informacion mbi çështjet të cilat janë jashtë sferës së përvojës tonë personale dhe perceptimit të menjëhershëm, ne duhet të mbështetemi në një medium të informacionit.

Mirëpo, qasja individuale në mediat e ndryshme, ndryshon shumë. Kjo ndikon në nivelin e informacioneve të personit dhe në potencialin e tij për të ushtruar ndikimin dhe pushtetin. Një aspekt tjetër i rëndësishëm është çështja e censurimit dhe problemi i keqinformimit nga partitë, qeveritë dhe grupet e fuqishme ndikuese. Konflikti, duke përfshirë ndryshimin shoqëror ose luftën, u hap rrugë informacioneve të monopolizuara dhe shtrembëruese.

Edhe pse këto raporte reciproke, t'i përmendim disa, nuk do të trajtohen në mënyrë të hollësishme në këtë njësi mbi mediat, nxënësit do të nxjerrin elemente nga ata kur të krahasojnë mediat e shkruara në vendin apo regjionin e tyre, dhe t'i gjykojnë ata sipas kriterëve specifike.

Qasja në edukimin për mediat në këtë njësi është e ndryshme. Duke përgatitur gazetën e tyre të murit, nxënësit do të fitojnë ca njohuri mbi përgatitjen e gazetës, dhe kështu do të mësojnë diçka për të vërtetën e mediave “nga brenda”. Përvoja e mësimdhënies ka treguar se kjo qasje nxënësve u mundëson një qasje të drejtpërdrejtë në mediat e shkruara, që është pak e mundshme në jetën e tyre të përditshme. Nxënësit do të shqyrtojnë këtë lloj të mediave në mënyrë kritike dhe do të vlerësojnë edhe mediat elektronike, si dhe përdorimin e këtyre mediave të ndryshme nga ata, nga një perspektivë e re. Ata do të zhvillojnë njohuri për mediat.

Më në fund, një informatë praktike: kjo njësi, në veçanti, kërkon dhe ofron mundësi për mësimdhënie ndër-kurrikulare dhe për bashkëpunim. Shkrimi dhe rishikimi i teksteve mund të bëhet si pjesë e mësimin të gjuhës, kurse dizajnit të faqes mund të jetë detyrë për orën e artit. Në disa raste, klasa ndoshta duhet të fillojë punën në mënyrë të pavarur, me ndihmë shtesë nga një ekip i redaktorëve të nxënësve, të cilët veçanërisht janë të interesuar.

Gazeta e murit ndoshta duhet të jetë e pranishme në jetën e shkollës për ca kohë para se të binden mësimdhënësit tjerë për vlerën e marrjes pjesë në një aktivitet të tillë.

Të mësuarit për Edukimin e Qytetarisë Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

Njohuritë për mediat është njëri prej çelësave të objektivit të përgjithshëm të të drejtave të njeriut dhe edukatës qytetare – qytetari aktiv dhe qytetari pjesëmarrës. Më poshtë është dhënë një përmbledhje e aspekteve më të rëndësishme të njohurive për mediat

- 1 Aftësia e komunikimit i referohet mënyrës së përgjithshme në të cilën njerëzit bashkëveprojnë me njëri tjetrin. Realiteti shoqëror si i tillë nuk ekziston. Më saktë, ai përcaktohet nga njerëzit përmes bashkëveprimit shoqëror, që do të thotë se krijohet përmes akteve të komunikimit. Kjo aftësi e përgjithshme komunikuese fillon me mësimin e gjuhës sonë amtare, dhe zhvillohet tutje me përdorimin e kësaj aftësie në publik.
- 2 Çdo njeri e ka këtë aftësi komunikuese nga lindja. Këtë aftësi e kemi dhuratë nga natyra, por kjo duhet të shkollohet, të ushtrohet dhe të përpunohet.
- 3 Aftësia për mediat është përfshirë në konceptin që mbulon aftësinë komunikuese. I referohet morisë komplekse të mediave, përdorimi i të cilës duhet të mësohet dhe të ushtrohet, për shembull, përmes caktimit të kësaj si detyrë për nxënësit. Mediat e shkruara, duke përfshirë gazetën e murit, janë mjete të rëndësishme të komunikimit të përditshëm, për të cilat nxënësit duhet të njoftohen. Mirëpo, ata nuk janë asgjë më shumë se një element në kuadër të qëllimit të përgjithshëm të njohurisë për mediat.

NJËSIA 7: Gazeta e klasës

Të kuptuarit e mediave përmes përgatitjes së tyre

Titulli i mësimit	Objektivat	Detyrat e nxënësve	Burimet	Metodat
Mësimi 1: Gazetat përreth nesh	Nxënësve u paraqitet një shumëllojshmëri e mediave të shkruara. Ata e kuptojnë dallimin në strukturën e përmbajtjes.	Nxënësit mbledhin dhe analizojnë gazeta dhe revista të cilat zakonisht lexohen në komunitetet e tyre. Ata bëjnë një poster për të shënuar rezultatet e tyre.	Gazeta, gërshtë, ngjitës, fletë të mëdha të letrës.	Punë në grupe.
Mësimi 2: Gazeta jonë është më e mira ... a nuk po pajtohesh?	Nxënësit i qartësojnë kriteret për një gazetë apo revistë të mirë. Ata janë të vetëdijshëm për pikëpamjet e tyre, për vlerat dhe për interesat.	Nxënësit vlerësojnë prezentimet nga grupet tjera dhe pranojnë kompromise.	Prezentimet e përgatitura në mësimin paraprak. Matrica në dërrasën e zezë ose në tabelën shfletuese (flip chart).	Prezentime në grupe, diskutim plenar dhe vlerësim.
Mësimi 3: Ne përgatisim gazetën e murit	Në grupe, nxënësit bien në ujdë për një sërë temash dhe objektivash. Ata bashkëpunojnë në grupe, duke i shkëmbyer idetë e tyre dhe aftësitë me ekipin.	Nxënësit vendosin për strukturën e gazetës së tyre të përgatitur bashkërisht. Ata identifikojnë tema të cilat janë relevante për shkollën e tyre, dhe shkruajnë një artikull për rubrikën e tyre në gazetën e murit.	Varësisht nga burimet materiale që i kanë në dispozicion, rezultatet do të radhiten prej teksteve në dorëshkrim në tekste të shtypura në kompjuter me fotografi digjitale.	Marrja e vendimeve të përbashkëta, punë në grupe.
Mësimi 4: Çështja jonë e parë!	Në një diskutim të hapur, nxënësit kuptojnë se çka përfshihet në vazhdimin e projektit të gazetës në mur. Ata janë të aftë të marrin një vendim dhe të marrin përgjegjësi për të.	Nxënësit duhet të krijojnë opinionet dhe të vendosin për përfshirjen e tyre në një projekt pasues në të ardhmen.	Dërrasa e zezë apo tabela shfletuese (flip chart).	Diskusim plenar.

Mësimi 1

Gazetat përreth nesh

Kë e informojnë. Si na informojnë. Çka na kumtojnë ata.

Objektivi i mësimnxënies	Nxënësve u paraqitet një shumëllojshmëri e mediave të shkruara. Ata e kuptojnë dallimin në strukturën e përmbajtjes.
Detyrat e nxënësit	Nxënësit mbledhin dhe analizojnë gazeta dhe revista të cilat zakonisht lexohen në komunitetet e tyre. Ata bëjnë një poster për të shënuar rezultatet e tyre.
Burimet	Gazeta, gërshtë, ngjitës, fletë të mëdha të letrës. .
Metoda	Punë në grupe.

Të mësuarit konceptual

Shprehja “media të shkruara” u referohet burimeve të shkruara të informacionit – të ashtuquajtura media klasike – duke përfshirë gazetatat, revistat, librat, katalogët, reklamat, prospektet e reklamave, hartat, diagramet, kartolinat, kalendarët dhe afishet.

Mediat e shkruara zakonisht janë të shtypura në letër. Teknologjitë e shtypjes janë duke pësuar ndryshime rapide, dhe shtypja digjitale po bëhet gjithnjë e më e zakonshme.

Mësimi

Disa javë përpara se të fillojë ky mësim, mësimdhënësi kërkon që nxënësit të grumbullojnë të gjitha gazetatat dhe revistat që u bien në dorë dhe ato t'i sjellin në shkollë. Për të mbështetur nxënësit në punën e tyre, rekomandohet që një tavolinë të lihet në një anë të klasës ku mund të përdoret për prezantime. Nëse ka fat, një nxënës mund të gjejë ndonjë mbajtëse të vjetër të gazetave nga gazetashitësi, që është një mënyrë ideale për paraqitjen e gazetave dhe revistave. Mësimdhënësi duhet të sigurojë përfshirjen e të gjitha gazetave kryesore ditore.

Mësimdhënësi e fillon mësimin e parë duke i informuar nxënësit për objektivat dhe detyrat e kësaj njësie. Mësimdhënësi duhet të theksojë se kjo njësi është fillimi i një projekti i cili mund dhe duhet të vazhdohet për së paku një gjysmë viti shkollor. Nxënësit gjithashtu duhet të kuptojnë se ky projekt atyre u ofron mundësinë që të fitojnë përvojë praktike të gazetarisë. Përvoja ka treguar se gazetarët shpesh kanë ndërmarrë hapat e para në projekte të këtij lloji.

Nxënësit formojnë grupe të vogla, më së mirë me tre apo maksimumi me katër vetë. Çdo grup duhet të analizojë një gazetë apo revistë të ndryshme. Në punën e tyre nxënësit drejtohen nga pyetjet vijuese:

- Cilat rubrika janë të përfshira në gazetë apo në revistë?
- Cila është renditja e rubrikave?
- Cilave grupe u drejtohen këto rubrika? Cilët anëtarë të familjes veçanërisht janë të interesuar për leximin e një rubrike të caktuar?
- Cilat tema janë mbuluar në rubrikat e çështjes që është duke e analizuar grupi?
- Zgjidhni nga një artikull karakteristik nga çdo rubrikë. Pritni këto artikuj dhe ngjitni në një fletë të letrës për të bërë një poster.

Në poster duhet shënuar emrin e gazetës ose të revistës, më së mirë me titullin origjinal, dhe duhet t'ju përgjigjeni pyetjeve të lartshënuara. Nxënësit duhet përkujtuar për rëndësinë e një faqosje të qartë dhe të sistemuar.

Në këtë fazë, për nxënësit është me rëndësi të kenë kuptuar strukturën themelore të gazetës së tyre, që do t'ju mundësonte ta paraqesin dhe ta shpjegojnë qartë në klasë.

Grupet përgatisin prezentimet për mësimin e ardhshëm, thuajse e reklamojnë gazetën apo revistën e tyre, duke theksuar të gjitha përparësitë dhe anët e saj të forta. Pasi t'i kenë dëgjuar të gjitha prezentimet, klasa duhet të vendosë se cilën gazetë e konsiderojnë të jetë më interesante dhe më informuese. Qëllimi i këtij hapi është që të fitohet shpërndarje falas e kësaj gazete për disa javë, një shërbim të cilin shumë botues të gazetave janë të gatshëm t'ua ofrojnë shkollave.

Në këtë fazë, mësimdhënësi ka rol këshillëdhënës. Ai i ndihmon grupet në studimin e strukturës së brendshme të gazetës, meqë nuk janë të gjitha gazetatat njëlloj të lehta për t'u analizuar. Mësimdhënësi gjithashtu duhet të vëzhgojë nxënësit gjatë punës së tyre në grupe për të siguruar se çdo grup është në gjendje të bëjë një prezentim të mirë dhe të përfundojë punën deri në fund të mësimit. Përpjekja për të qenë shumë të përsosur do të prishë planifikimin e kohës për këtë aktivitet.

Mësimi 2

Gazeta jonë është më e mira ... a nuk po pajtohesh?

Çka e bën një gazetë të jetë gazetë e mirë?

Objektivi i mësimnxënies	Nxënësit i qartësojnë kriteret për identifikimin e një gazete apo reviste të mirë. Duke e bërë këtë, ata bëhen të vetëdijshëm për pikëpamjet e tyre, për vlerat dhe për interesat.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit vlerësojnë prezentimet nga grupet tjera dhe pranojnë kompromise.
Burimet	Prezentimet e përgatitura gjatë mësimit të kaluar. Dërrasa e zezë apo tabela shfletuese (flip chart).
Metoda	Prezentime në grupe, diskutim plenar dhe vlerësim.

Të mësuarit konceptual

Shprehja “liria e shtypit” i referohet të drejtës së gazetarëve që ata punën e tyre ta bëjnë lirshëm, së bashku me të drejtën për publikim të pacensuruar të informacioneve dhe opinionëve të tyre. Liria e shtypit e merr formën konkrete me të drejtat specifike të gazetarëve për të refuzuar dhënien e dëshmimeve dhe kufizimeve mbi gazetarët vëzhgues me audio pajisje (“të përgjimit”), për të mbrojtur burimet e informacioneve të cilat gazetarëve u nevojiten për punën e tyre. Qasja në profesionin e gazetarisë nuk i nënshtrohet rregullimit nga shteti, dhe trajnimi i gazetarëve organizohet në mënyrë private dhe nuk ndikohet nga shteti.

Mësimi

Mësimi i dytë fillon me prezentime. Grupet i kanë përgatitur posterat dhe kanë përzgjedhur copat e prera nga gazetatat apo revistat. Është mirë që grupet të kenë pesë minuta në fillim të mësimit për të përsëritur prezentimet e tyre.

Nxënësit i vlerësojnë prezentimet përmes kriterëve të përcaktuara. Mësimdhënësi mund t'i paraqesë këto kriterë dhe të përgatisë një matricë si më poshtë.

	Grupi 1	Grupi 2	Grupi 3	Grupi 4	Grupi 5	Pikat
Emri i gazetës apo revistës						
Posteri						
Aspektet formale të prezentimit						
Përmbajtja e prezentimit						
Aspektet formale të gazetës apo revistës						
Përmbajtja e gazetës apo revistës						

Vlerësimi nuk duhet dhënë rëndësinë e nevojshme por, përmes elementit të konkurrencës, nxënësit të motivohen që të paraqesin një prezentim të mirë.

Pas prezentimit, nxënësit duhet të vlerësojnë mediat e shkruara të cilat ata i kanë parë (të menduarit kritik), duke u përqendruar në pyetjet vijuese:

- Çka e bën një gazetë/revistë të jetë gazetë/revistë e “mirë”?
- Çfarë qëllimi i shërben?
- Çka mendojmë ne për gazetatat/revistat të cilat na i kanë prezentuar?
- Çka mund të përmirësohet?

Përvoja ka treguar se mësimdhënësi mbështet dhe i jep strukturën diskutimit, duke i shënuar idetë e nxënësve në tabelën shfletuese, e cila është përgatitur para mësimit. Mund të përdoret edhe dërrasa e zezë, por kjo e ka një të keqe se informacionet nuk do të jenë në dispozicion në mësimin e ardhshëm.

Në fund të mësimit, mësimdhënësi u sugjeron nxënësve që të përgatisin dhe të prezantojnë publikisht një gazetë shkollorë “të murit”. Nga nxënësit duhet të kërkojmë që ata të mendojnë për këtë detyrë dhe të mendojnë se cilat rubrika duhet të përfshihen në të, në mënyrë që ata të japin një pasqyrë gjithëpërfshirëse të jetës shkollore, dhe cilën rubrikë ata do të donin ta përgatisin vetë. Ata gjithashtu duhet të sugjerojnë një emër për gazetën e tyre.

Mësimi 3

Ne përgatisim gazetën tonë të murit

Të gjitha gjërat që “duhet bërë” dhe pak gjëra që “s’duhet bërë”

Objektivi i mësimnxënies	Në grupe, nxënësit bien në ujdi për një varg temash dhe objektivash. Ata bashkëpunojnë në grupe, duke i shkëmbyer idetë dhe aftësitë e tyre me ekipin.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit vendosin për strukturën që do ta ketë gazeta e tyre e përgatitur bashkërisht. Ata identifikojnë tema të cilat janë relevante për shkollën e tyre, dhe shkruajnë një artikull për rubrikën e tyre në gazetën e murit.
Burimet	Varësisht nga burimet materiale që i kanë në dispozicion, rezultatet do të radhiten prej teksteve në dorëshkrim në tekste të shtypura në kompjuter me fotografi digjitale.
Metodat	Marrja e vendimeve të përbashkëta. Punë në grupe.

Mësimi

Në grupe me nga tre apo katër, nxënësit shkëmbejnë idetë e tyre se cilat rubrika të gazetës ofrojnë informacione relevante për jetën në shkollë.

Mësimdhënësi ka përgatitur një gazetë të vogël të murit për çdo grup, duke i ngjitur së bashku tri fletë të letrës të formatit A4. Pastaj grupeve u caktohet detyra e dizajnit të strukturës së përgjithshme të gazetës, duke përfshirë edhe emrin e gazetës, faqosjen e mundshme dhe rubrikat të cilat i kanë zgjedhur nxënësit. Rezultati i tyre mund të duket kështu:

Kronika e nxënësve		
<u>Lajmetmëtereja</u>	<u>Sporti</u>	<u>Lajmetënivelitëllartë Ngjarjet</u>
		<u>Prindërit</u> <u>Shqetësimet tona</u>

Sugjerimet e bëra nga grupet ekspozohen në murin e klasës dhe nxënësve u jepet kohë të lexojnë posterat dhe të krijojnë opinionet e tyre. Pastaj, në një “konferencë të redaktorëve” merren vendimet e rëndësishme vijuese:

- Emri i gazetës (shkëmbim i mendimeve, diskutim dhe votimi përfundimtar);
- Përzgjedhja e rubrikave të cilat janë më të rëndësishme dhe më domethënëse për shkollën dhe nxënësit.

Nxënësit tani formojnë ekipe të vogla, ku numri i ekipeve korrespondon me numrin e rubrikave të cilat duhet të përgatiten, me një ekip shtesë i cili ngarkohet me përgatitjen e gazetës.

Në fillim, ekipi për përgatitje merret me çështje praktike siç është faqosja dhe prezentimi i gazetës së murit. Që më parë, mësimdhënësi ka informuar kujdestarin e klasës për projektin e gazetës dhe e ka marrë lejen e tij për ta ekspozuar gazetën e shkollës në objektin shkollor.

Derisa ekipet e redaktorëve po i planifikojnë artikujt e parë për rubrikat e ndryshme, mësimdhënësi diskuton për aspektet teknike me ekipin e përgatitjes.

Nxënësve u jepen detyra të cilat duhet të përfundohen javën vijuese. Çdo ekip redaktues dorëzon një artikull dhe ekipi për përgatitje e përgatit gazetën e murit, e kompletton me dizajnin e titullit, që tregon shenjën dalluese, dhe emrin e gazetës, si dhe rubrikat e përzgjedhura.

Kjo detyrë u mundëson nxënësve të përjetojnë suksesin e tyre të parë, por gjithashtu ata menjëherë i ballafaqon me vështirësitë që i ka kjo detyrë. Objektivi i kësaj qasje është që të krijohet një ekip i përhershëm i redaktorëve, të cilët rregullisht do të botojnë lajmet e shkollës. Ekipet do të përbëhen nga nxënësit të cilët veçanërisht janë aktiv dhe të interesuar, dhe janë në gjendje të vazhdojnë me projektin e gazetës së murit për një periudhë të gjatë kohore.

Mësimi 4

Çështja jonë e parë!

Cilët janë hapat e ardhshëm?

Objektivi i mësimnxënies	Nxënësit janë në gjendje të drejtojnë një diskutim të hapur dhe ata bëhen të vetëdijshëm për implikimet dhe pasojat e vazhdimit të projektit të gazetës. Ata janë në gjendje të marrin një vendim dhe të marrin përgjegjësi për të.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit duhet të krijojnë opinionet dhe të vendosin për përfshirjen e tyre në të ardhmen në një projekt pasues.
Burimet	Dërrasa e zezë apo tabela shfletuese (flip chart).
Metoda	Diskutim plenar.

Të mësuarit konceptual

Diskutimi (një shkëmbim i argumenteve, që rrjedh nga latinishtja, discussio) është një formë specifike e komunikimit verbal në mes të dy apo më tepër personave, në të cilin trajtohet një apo më shumë çështje, ku secila palë paraqet argumentet e veta. Diskutimi duhet të mbahet në frymën e respektit të ndërsjellë. Një mënyrë e mirë e diskutimit kërkon që folësit të lejojnë, madje dhe të inkurajojnë, shprehjen e synimeve dhe të opinioneve të tjerëve, duke i shqyrtuar ato me kujdes dhe jo duke i refuzuar menjëherë. Kualitetet personale siç janë qetësia, vetëpërmbytja dhe mirësjellja do të jenë dobiprurëse për të dyja anët. Mënyra më e mirë e diskutimit shpie në zgjidhjen e një problemi apo në kompromis, të cilin çdokush që është i përfshirë në atë diskutim mund ta pranojë.

Në shoqëritë moderne, diskutimet janë mënyrë e civilizuar, d.m.th., mënyrë e padhunshme e trajtimit të polemikave dhe konflikteve e qëllimeve të interesit. Konfliktet nuk frenohen, por zgjidhen. Duke i ushtruar shkathtësitë e tyre për diskutim, nxënësit mësojnë mjetin themelor për të punuar në drejtimin të arritjes së paqes dhe ruajtjes së saj në shoqëri.

Mësimi

Pasi që ekipet e redaktorëve t’i kenë ngjitur artikujt e tyre në mur dhe të kenë raportuar shkurtimisht për përvojën e tyre të punës, në vazhdim përqendrohen në çështjen nëse do të vazhdojnë me projektin e gazetës së murit. Tani që të gjithë nxënësit pak a shumë e dinë kohën që do t’ju nevojitet për këtë aktivitet dhe problemet organizative të cilat duhet zgjidhur, ata mund të zhvillojnë diskutime reale për çështjen e vazhdimin të gazetës.

Mësimdhënësi mund të ndihmojë në dhënien e sqarimeve dhe përcaktimin e strukturës së diskutimit të nxënësve, duke i ofruar ato më posht në tabelën shfletuese ose në dërrasën e zezë.

Organizimi	Aspektet personale	Bashkëpunimi	Menaxhimi i kohës
Nëse ne vazhdojmë: – Çka duhet të marrin parasysh? – A do të jetë koha problem? – Çfarë mjetesh teknike kemi? – Si mund ta parandalojmë që gazeta jonë të mos vandalizohet? – Çfarë mjetesh financiare do të na nevojiten? Si mund të mblidhen fondet?	Kush është i interesuar? – Kryeredaktori? – Komiteti i redaktorëve? – Cili është roli dhe pozicioni i mësimdhënësit? – Emrat: – – – –	– Si mund të tërheqim interesimin e nxënësve të tjerë? – Cilët mësimdhënës të tjerë do të dëshironim ne t’i bashkëngjiten projektit tonë? – A mund të caktojmë vizita në zyrat lokale redaksionale (mediat e shkruara, transmetimin ose mediat elektronike)? – A mund të intervistojmë një gazetar si ekspert?	

Posa mësimdhënësit të fillojnë një projekt siç është ky, ata do të kuptojnë se nuk mund të planifikohet çdo gjë. Për këtë nevojitet një proces i reflektimit të vazhdueshëm nga të gjithë pjesëmarrësit. Është një proces energjik, magjepsës, por edhe i vështirë dhe ndonjëherë madje edhe frustues.

Mësimdhënësit të cilët kanë përvojë në punë me projekte me klasë, do t’i dinë rrjedhat e hapave të cilat nevojiten, dhe ata gjithashtu e dinë se një udhëheqësi e fuqishme është e domosdoshme. Mirëpo, po të mos kemi kujdes, një udhëheqësi e fuqishme e tepruar mund, natyrisht, edhe të thyej motivimin dhe iniciativën e nxënësve. Pjesëmarrja në projekte të tilla është në dobi të nxënësve, sepse ata fitojnë një përvojë të rëndësishme në edukimin qytetar dhe në atë të drejtave të njeriut.

Mësimdhënësit duhet të ushtrojnë shkathtësitë e tyre të udhëheqësisë për të siguruar që, deri në fund të këtij mësimi, të merren vendime të qarta dhe të caktohet një kornizë adekuate kohore për hapat e ardhshëm.

Informacionet e prapaskenës vetëm për mësimdhënësit

Tri dimensione të zhvillimit të njohurive për mediat

1. Dimensioni i parë: gjykimi i mediave

Gjykimi i mediave mund të përmblihet me foljen e lashtë greke Κρίνειν (krinein), e cila fillimisht e kishte kuptimin “me dallua” dhe i referohej përvetësimit dhe përhapjes së vazhdueshme të dijes dhe përvojës.

Gjykimi i mediave është shqyrtimi (analiza) e mediave. Ky nëndimension analitik i referohet aftësisë për të perceptuar dhe kuptuar zhvillimet në shoqëri, siç është procesi i përqendrimit në punën e mediave, që mund të rrezikojë funksionimin e mediave në një shoqëri demokratike. Në këtë shembull, është me rëndësi të dihet se kush është pronar i cilës gazete dhe sa lloje të mediave janë në pronësi të kompanisë së njëjtë. Mirëpo, nuk duhet të harrojmë se mediat drejtohen si ndërmarrje komerciale të cilat duhet të nxjerrin një përfitim. Dhe na pëlqeu apo s’na pëlqeu neve, sa më të ndërvarura dhe të globalizuara që bëhen jetët tona, aq më shumë kemi nevojë të mbështetemi në mediat. Analiza e mediave na mundëson të gjykojmë zhvillimet e mediave në mënyrë kritike – të bëjmë dallime – ashtu që ne në mënyrë adekuate të mund të shfrytëzojmë aftësitë tona për mediat.

Nëndimensioni (vetë-) pasqyruar do të thotë se ne duhet të jemi në gjendje të lidhim dhe të përdorim potencialin dhe njohuritë tona analitike për veten tonë dhe sferën tonë personale të veprimit. Veçanërisht, kur kemi të bëjmë me mediat, kemi një tendencë të fuqishme që të flasim për “të tjerët” dhe të injorojmë përfshirjen tonë personale.

Aftësia për të analizuar dhe për të reflektuar përfshin një nëndimension të tretë, interesimin etik për të tjerët, që balancon dhe përcakton të menduarit analitik dhe vetë-pasqyrimin nga pikëpamja e përgjegjësive shoqërore.

2. Dimensioni i dytë: njohuritë për mediat

Këtu u referohemi njohurive “të thjeshta” për mediat dhe sistemeve të mediave. Kjo mund të ndahet në dy nëndimensione.

Nëndimensioni i informacioneve përfshin njohuritë themelore siç është interesimi se si gazetarët e kryejnë punën e tyre, llojet e programeve të cilat transmetohen në TV dhe radio, arsyet për preferencat e shikuesit kur shikon TV-në dhe si mund të përdoret kompjuteri, që në mënyrë efektive t’u shërbejë nevojave të përdoruesit.

Nëndimensioni i shkathtësive ua shton njohurive të mediave aftësinë për të përdorur pajisje të reja pa pasur nevojë të lexohen doracakët e udhëzimeve. Kjo përfshin procesin “mësojmë duke punuar” – si të përdoret kompjuteri, si t’i qasemi Internetit, si të përdoret një video-kamerë, etj.

3. Dimensioni i tretë: përdorimi i mediave

Përdorimi i mediave gjithashtu mund të ndahet në dy nëndimensione:

- 1 Aftësia për shfrytëzimin e produkteve të mediave, d.m.th., pranimi dhe konsumimi i asaj që e kanë përgatitur mediat. Një shembull për këtë është shikimi i TV-së. Është një aktivitet gjatë të cilit ne duhet të përpunojmë atë çka e kemi parë, dhe ta integrojmë atë në strukturat tona kognitive (njohëse) dhe në repertorin tonë të figurave. Në ditën e sotme, ne mund të përmirësojmë aftësitë tona perceptuese jo vetëm përmes leximit të teksteve, por edhe përmes shikimit të filmave.
- 2 Shfrytëzim aktiv i pajisjeve të mediave. Ky nëndimension i referohet shfrytëzimit të mediave në bashkëveprimin shoqëror. Si shembuj mund të përmendim shërbimin telebankar, teleblerjen, video dhe telekonferencat, fotografinë tradicionale dhe digjitale dhe video produksionin. Llojllojshmëria e pafund e mediave në dispozicion na jep mundësinë që të perceptojmë botën jo vetëm përmes pranimi të informacioneve, por edhe përmes përgatitjes së informacioneve.

Njësia për mediat përqendrohet pikërisht në shfrytëzimin e tillë aktiv të mediave, por përfshin lidhjet në dy dimensionet tjera të edukimit për mediat, të përmendura më lart.

Prospektet për nxënës 7.1

Si të shkruajmë një artikull

Struktura themelore e një artikulli

1. Titulli i artikullit

Çdo artikull duhet të ketë titull. Titulli plotëson një funksion të rëndësishëm: ai nuk duhet ta hutoj lexuesin, por duhet të tërheqë vëmendjen e tij dhe të zgjojë interesimin për të lexuar më tutje.

Lexuesit e gazetave lexojnë kalimthi shpejt e shpejt faqet për të përzgjedhur artikujt që atyre u interesojnë, dhe për këtë arsye titujt e artikujve duhet të kapin syrin e lexuesit. Shënoni tituj të shkurtër të artikujve, përdorni shkronja të mëdha të zeza dhe ndani titullin e artikullit nga teksti pasues.

2. Nëntitujt

Nëntitulli është zakonisht paragrafi i parë i artikullit tuaj (prodhuesit e gazetave këtë e quajnë “kokë”). Si rregull, shënohet me shkronja të zeza.

Koka i jep lexuesit informacionet më të rëndësishme. Në një tekst informativ kokë, lexuesi gjen përgjigjet në pyetjet kyçe.

Në tekste artistike dhe në tekste të tjera që janë emocionale dhe jo faktike, rreshtat e parë shpesh përshkruajnë qartë pamjen/vendin e ngjarjes. Në këtë rast, interesimi i lexuesit për të lexuar tutje nuk zgjohet nga informacionet faktike, por nga mënyra stilistike.

3. Përdorimi i gjuhës dhe stilit

Përdorimi i kujdesshëm dhe i menduar mirë i gjuhës është ndoshta edhe më i rëndësishëm për një artikull të mirë sesa përdorimi i saktë i formës apo stilit gazetaresk. Po ta shikojmë gazetën si një shtëpi, atëherë format e ndryshme të shkrimit dhe prezentimet gazetareske mund të jenë mobiliet, por fjalët do të ishin tullat me të cilat është ndërtuar shtëpia.

Derisa pa mobilie disi mund t’ia dalim, ne nuk do të mund të jetonim në një shtëpi pa tulla. Artikujt e shkruar në mënyrë emocionale, me “ndjenja njerëzore”, janë shumë të popullarizuara në gazeta. Por kini kujdes, kripa e tepërt e prish gjellën (teprim është i dëmshëm)!

Kjo na sjell tek fjalitë që duhet përdorur në artikull. Shënoni fjali të shkurtra dhe të thjeshta. Lexuesit do të kenë vështirësi të kuptojnë fjalitë me më shumë se 14 fjalë. Dhe fjalitë me 25 fjalë ose më shumë janë thjeshtë të pakuptueshme. Në çdo rrethanë, shmanguni strukturës së fjalisë së përbërë, e cila përfshin shumë presje dhe fjali të thjeshta të ndara. Bëjeni shprehi të lexoni çdo fjali menjëherë pasi ta keni shkruar atë. A është e qartë dhe e lehtë për t’u kuptuar? A ka fjalë të panevojshme?

Gabimet drejtshkrimore jo vetëm se lënë një përshtypje të keqe, por edhe e zemërojnë lexuesin, sepse e largojnë vëmendjen e tij nga porosia. Para se të dorëzoni artikullin tuaj, rishikojeni atë – dhe kjo do të thotë të kontrolloni nëse informacionet janë të sakta dhe të plota (d.m.th. të kontrolloni vërtetësinë dhe saktësinë e informacionit), gabimet gjuhësore, stilin dhe kuptueshmërinë.